



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 05
Prishtinë, më 09. 03. 2010, ora 13:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Ismet Beqiri – Kryetar, Nerxhivane Dauti, Hajredin Hyseni, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Danush Ademi, Drita Maliqi dhe Shpresa Murati.

I ftuar : ishte z. Fatmir Fehmiu- kryetar i Sindikatës Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës

Mbledhjen e monitoruan: –Nexhat Shatri - Zyra Presidentit, Rrezarta Ahmeti KDI

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj ,koordinator, Visar Krasniqi zyrtar ligjor .

Mbledhjen e drejtoi: Ismet Beqiri.

Kryetari konstatoi se në bazë të Rregullores së Punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës janë plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

R e n d i t ë

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18. 02. 2010
3. Takim i përbashkët me OSBE-n , lidhur me shkoqitjen e pikave të Planit të Veprimit me të cilat ngarkohet Komisioni ,
4. Caktimi i kryesuesve të seksioneve të tryezës rrumbullaket
- 5 Shqyrtimin e petitionit te pensionerve te Sindikatës Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës

Kryetari i propozoi Komisionit që për shkak të zënies me punë të z. Fatmir Fehmiut ,pika e 5 e të kaloi në pikën e tretë të rendit të ditës Gjithashtu ,

Komisioni u pajtua që si pikë e veçantë e rendit të ditës të vihet kërkesa e R.A.nga Prishtina .

1 Rendi i ditës u miratua me vërejtje e dhëna

2 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18. 02. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejtje procesverbalin e datës 18. 02. 2010.

3 Shqyrtimin e petitionit te pensionerve te Sindikatës Pavarur e Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës

Ismet Beqiri -kryetar, Komisionit i ka mbërritur peticioni i nënshkruar nga 3837 nënshkrime të cilët shprehin pakënaqësi lidhur me statusin e tyre të pa rregulluar. Ne sot e kemi ftuar z.Fatmir Fehmiun kryetar (SPPIK) ku do të njoftoi ne pika të shkurta problemet me të cilat ballafaqohen pensionistet dhe pastaj do të marrë qëndrim Komisioni rreth mbajtjes se një dëgjimit publik . Ai e ftoi qe të marri fjalën.

Z. Fatmir Fehmiu, lidhur me peticion tha” Se ende vazhdon të nënshkruat peticioni i cili i përmban kërkesat e tyre të cilat kërkohen të shqyrtohen nga Komisioni. Ai i ishte i mendimit se deri tek kjo situatë ka ardhur për shak të moszbatimit të dispozitave të Kushtetutës Republikës së Kosovës . Peticionin e quajti si rezultat të punës tetë vjeçare i punëtoreve shkencorë dhe profesional. Ne ketë kontest, pati vërejtje të përfaqësuesit e institucioneve shtetërore që nuk ishin të pranishëm ne tryeza që i organizoni sindikata qe nga viti 2003. Gjithashtu tha se rekomandimet e miratuara nga Kuvendi i Kosoves që lidhen me pensionistet deri me tani nuk janë zbatuar Komisionit i kërkoi të marri hapa konkret për organizimin e dëgjimit publik me qëllim që të debatohen problemet e pensionistëve .

Kryetari, e mbështeti diskutimin e prerzntuar dhe tha se Komisioni do t'i ofroi mbështetje Sindikatës Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës brenda fushëveprimit të tij, duke atij të hartoj listën e institucioneve që i konsideron së do japin kontribut në dëgjimin publikë . Komisioni pas e dëgjoi kryetarin e Sindikatës Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Kosovës, nxori këtë :

P ë r f u n d i m

Komisioni vendosi që në mbledhjen e radhës të caktoj datën e organizimit të dëgjimi publik lidhur me shqyrtimin e kërkesave të petitionit të Sindikatës së Pavarur të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës së Kosovës (SPPIPK).

4. Caktimi i kryesuesve të seksioneve të tryezës rrumbullaket

Kryetari, Komisionit ia propozoi emrat e kryesueseve të sesioneve të cilat do të udhëheqin seksionet më 18.shkurt 2010 ne Hotelin “Grand “

- 1 . Znj Nerxhivane Dauti , kryesuese e seksionit për Parandalim ,
- 2 Z. Hajredin Hyseni , kryesues i seksionit për sanksionim dhe
- 3 . Z .Ibrahim Makolli , kryesues i seksionit për rehabilitim

Ibrahim Makolli, duke u ndërlidhur rreth agjendës se tryezës ,kërkojë që me punë të fillojnë të njëjtën tri sesionet dhe do të duhej që kryesuesit e këtyre sesioneve të paraqesin arsyetimet në seancë plenare për sesionet qe ata i kanë udhëhequr .

Drita Maliqi, shtoi se tryeza e rrumbullaket ma tepër po duket si work – shop dhe në Mbledhjen e kaluar kamë propozuar që të jetë work – shop .

5 Takim i përbashkët me OSBE-n , lidhur me shkoqitjen e pikave të Planit të Veprimit me të cilat ngarkohet Komisioni

Kryetari,i njoftoi Komisionin me pikat Planit të Veprimit e që duhet të përpunohen Mirëpo tha është ftuar znj. Elita Vokshi ,por ishte e zënë me punë .Prandaj i kërkojë Komisionit të vazhdojë me shqyrtimin dhe të jepet pëlqimi se në cilat pika konsiderohet mbështetja e OSBE-së

Ibrahim Makolli, propozoi në Pikat .30,32,42,45,61 të Planit të Veprimit të kërkohet mbështetja e OSBE-së

Drita Maliqi,- beri vërejtje pikës 42 të Planit Veprimit lidhur me emërimin e zyrtareve për barazi gjinore në nivelet Komunale. Ajo konsideron qe ka shkelje të ligjit nga ministria e Pushtetit Lokal dhe kërkoi të ndryshohet Ligji për barazi gjinore qe ne vend të “zyrtarëve ligjor” të zëvendësohen me “ zyrë për barazi gjinore”. U pajtua me parafolësit lidhur me këtë pikë të ftohen përgjegjësit nga Kuvendet komunale sepse konsideron se ka shkelje të kësaj natyre, dhe shembull përmendi Komunën e Gjilanit .

6 Shqyrtimi i kërkesës së R.A. nga Prishtina

Znj. Nerxhivane Dauti në cilësi të raportuese lidhur me kërkesën **R.A. nga Prishtina** kërkon nga Komisioni Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione që të t'i rekomandojë Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zbatimin e vendimit Këshillit të Pavarur Mbikqyres të Kosovës nr 155/2010 të datës 25.01.2010, duke e sistemuar në punët,në pajtim me përgatitjen e tij profesionale.Prandaj , me seriozitet dhe kompetencë profesionale është shqyrtuar kërkesa dhe Komisionit i propozon të nxjerrë këtë:

P e r f u n d i m

- 1 Komisioni i rekomandon R.A që t'i kërkojë Ministrisë për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të zbatojë vendimin nr.155/2010 të datës 25.01.2010

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri
